



UNMIK



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË
MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY
MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE**

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 1 paragrafi 3 pika (ç). Ligjin për Tregtinë e Brendshme, neni 14, neni 38 paragrafi 38.1 pika (a dhe b) .Me qëllim të përcaktimit të kushteve minimale teknike sanitare dhe shëndetësore të cilat duhet ti përmbushin objektet e shitjes. Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Miraton:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2005/ 12

**PËR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE MINIMALE TEKNIKE PËR LOKALET
AFARISTE OBJEKTET E SHITJES ME SHUMICË DHE PAKICË DHE PËR
NDERMJETËSIM NË TREGTI**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë udhëzim përcaktohen kushtet minimale teknike të cilat duhet përmbushur objektet afariste (në tekstin vijues: objektet), pajisjet dhe stabilimentet në objektet shitëse për tregti me pakicë dhe shumicë, ushtrim të ndërmjetësimit në tregti si dhe kushtet për shitjen e mallit jashtë objekteve shitëse.

Neni 2

2.1 Objektet për shitje sipas dispozitave të këtij Udhëzimi janë:

- Objektet në të cilat ushtrohet shitja e mallrave me pakicë (shitoret me mënyra të ndryshme të shitjes, duke përfshirë vetëshërbimet, shtëpitë e mallrave,qendrat tregtare dhe depot për shitjen e mallrave me pakicë)
- Objektet në të cilat bëhet shitja e mallrave me shumicë
- Objektet në të cilat kryhet ndërmjetësimi në tregti

2.2 Shitja e mallit jashtë objekteve të shitjes nënkupton shitjen: në tregjet me pakicë, kioske, stenda, në hapësirat e blerësve, përmes televizionit, shitësve ambulant, automatëve, postës,, si dhe shitja në panairë dhe ekspozita.

Neni 3

3.1. Dispozitat e këtij Udhëzimi parashohin kushtet për ushtrimin e aktiviteteve tregtare për personat e regjistruar fizik dhe juridik të cilët ushtrojnë aktivitete tregtare ose ndërmjetësim në tregti si dhe për personat fizik dhe juridik nga neni 2 të Ligjit për tregti të brendshme.

3.2. Dispozitat e këtij Udhëzimi aplikohen edhe për personat juridik dhe fizik të cilët menaxhojnë dhe mbajnë tregje me pakicë dhe shumicë, edhe për organizatorët e panairëve.

Neni 4

4.1. Objektet duhet t'i përmbushin kushtet e përcaktuara të ndërtimtarisë, urbanistike, teknike, sanitare dhe kushteve preventive kundër zjarreve të parapara me akte tjera ligjore.

4.2. Lokalet duhet të ndërtohen ne vendet te cilat mundësojnë ushtrimin e tregtisë ose shërbimeve në mënyrë të pa penguar si dhe manipulim racional me mallra.

Neni 5

5.1 Objektet me sipërfaqe prej dhe më shumë se 1.200 m² duhet të kenë vende të përshtatshme të parkimit.

5.2 Objektet nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të posedojnë mjete dhe pajisje të përshtatshme për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, si dhe pajisje tjera të nevojshme për manipulim me mallin.

Neni 6

6.1 Lokalet duhet të jenë të ndërtuara, rregulluara, të pajisura dhe të kyçura në objektet dhe pajisjet e infrastrukturës komunale të: ujësjellësit, kanalizimit dhe energjisë, në pajtim me normat dhe rregullat teknike.

6.2 Përjashtim, nga paragrafi 1 i këtij neni, bëjnë lokalet që gjenden në zonat në të cilat nuk janë të ndërtuara objektet dhe stabilimentet e infrastrukturës komunale, e të cilat duhet të ndërtohen dhe të pajisen në përputhshmëri me normat dhe rregullat teknike.

6.3 Mbeturinat e ngurta duhet të tubohen në vendet e caktuara duke siguruar kushtet shëndetësore-teknike si dhe largimin e tyre në mënyrën e përcaktuar nga administrata lokale.

Neni 7

Lokalet duhet të jenë të ndërtuara, rregulluara dhe të pajisura në përputhje me normat dhe rregullat teknike me të cilat pengohet ndikimi i dëmshëm i mjedisit ose kafshëve në cilësinë dhe rregullsinë shëndetësore të mallrave në lokale.

II. LOKALET AFARISTE NË TË CILAT USHTROHET TREGTIA ME PAKICË

SHITORET

Dispozitat e përbashkëta

Neni 8

Shitorja në kuptim të këtij Udhëzimi është hapësira në të cilën ushtrohet tregtia me pakicë me mallra për konsumim të gjerë, shitja e mallit është e organizuar, në atë mënyrë që i punësuarit shërben blerësin në mënyrë të zakonshme (tradicionale) ose shitje, përmes vetë zgjedhjes së blerësve përkatësisht vetëshërbimit, si dhe përmes automatëve në kuadër të shitores ose me kombinimin e mënyrave të cekura të shitjes.

Dukja(Pamja) e jashtme

Neni 9

9.1. Hapësirën para hyrjes në shitore duhet rregulluar dhe përgatitur në mënyrën që të mundëson pastrim të lehtë dhe mirëmbajtje të sipërfaqes si dhe zgjidhje që mundëson hyrjen dhe daljen e pa penguar në shitore.

9.2. Nëse para shitores nuk ekziston teracë e rregulluar, pjesa para shitores dhe vitrinës së shitores duhet asfaltuar, betonuar ose e rregulluar me pllaka të gurit ose në ndonjë

mënyrë tjetër ashtu që të sigurojë lëvizje të lirë të personave dhe të mundësojë mbajtjen e pastërtisë.

Neni 10

Hapësira para hyrjes së shitores duhet të jetë e ndriçuar.

Neni 11

Në anën e hyrjes në shitore duhet në mënyrë të dukshme të vendoset firma e personit juridik dhe fizik, i cili ushtron tregtinë, si dhe shenjat dalluese për shitoren e caktuar (emri dhe numri i shitores, vendi i afarizmit etj)

Neni 12

12.1 Porta hyrëse e shitores duhet të jetë e gjerë të paktën 0.90 m.

12.2 Në rast se shitorja ka të ndara derën e hyrjes dhe daljes, në dyer duhet të jenë të vendosura në mënyrë të dukshme shenjat “hyrja” dhe “dalja”.

12.3 Dyert e hyrjes respektivisht të daljes duhet të jenë të gjëra në masën e mjaftueshme duke pasur parasysh llojin e mallit dhe mënyrën e përdorimit të mallit e që mundëson manipulim më të lehtë

Neni 13

13.1. Hyrja dhe qasja në shitore e cila ndodhet në oborr ose e lidhur për muri ndërtese duhet të jetë e rregulluar në pajtueshmëri me nenet 9 dhe 12 të udhëzimit.

13.2. Qasja në shitore nga pika 1 i këtij neni duhet të jetë e rregulluar në mënyrë që të ketë ndarje fizike dhe mos ti pengojë shfrytëzuesit e tjerë të ndërtesës(objektit) në shfrytëzimin e përbashkët të sipërfaqes.

Brendësia e shitores

Neni 14

14.1. Shitorja duhet të ketë lartësinë nga drita/poqi (nga dyshemeja e përpunuar deri tavani i përpunuar) më së paku 2.8 m.

14.2. Bënë përjashtim, nga paragrafi 1 i këtij neni dhe lartësia mundet të jetë edhe më e vogël se 2.8 m, mirëpo jo më e vogël se 2.2 m, më kusht që të jetë në përputhshmëri me rregulla të veçanta.

Neni 15

Gjatë orarit të punës shitorja duhet të jetë e ndriçuar me dritë natyrore ose dritë artificiale fuqia e të cilës duhet të jetë në pajtueshmëri me normat e caktuara.

Neni 16

16.1 Shitorja e cila është e ndërtuar në dy ose më shumë kate duhet të ketë gjerësinë e shkallëve 1.1 m ose pajisjet(mjet) për ngritje të mallit në rast se në shitore shiten prodhime të mëdha dhe të rënda.

16.2 Shitorja me sipërfaqe shfrytëzuese më të madhe se 1200 m² në dy e më tepër kate duhet të posedojnë ashensor për më shumë se 4 persona ose shkallët lëvizëse.

Neni 17

17.1. Dyshemetë e shitoreve duhet të ndërtohen prej materialeve të cilët mundësojnë pastrim të lehtë (teraco, gur, pllaka qeramike, gomë e të ngjashme) dhe duhet të jenë të rafshta të lëmuara dhe jo të rrëshqitshme.

17.2. Në vendet ku të punësuarit kryejnë detyrat e punës, dyshemetë e shitores duhet të jenë konform me rregullat e përcaktuar për mbrojtje në punë.

17.3. Muret dhe tavanet e shitores duhet të jenë të rregulluara , të lyera dhe nuk lejohet të jenë të dëmtuara si dhe duhet të jenë të mbrojtura nga lagështia

17.4. Pjesët e shitores të cilat i ekspozohen më shumë ndotjes së mureve (ku shiten mishrat e freskëta e të ngjashme), muret duhet mveshur me pllaka qeramike apo materiale të përshtatshme në lartësi jo më pak se 1.80 m nga dyshemeja .

Neni 18

Shitoret me sipërfaqe shfrytëzuese prej dhe më shumë se 600 m², duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme për nevojat shëndetësore/sanitare të blerësve, dhe atë të ndara në dy grupe, një për meshkuj (i njëjti grup duhet të posedoj së paku një pisoar (WC), dhe të pajisur me ujë të nxehtë dhe të ftohtë), dhe një grup për femra (me kushte të njëjta si ai për meshkuj). Pajisjet duhet të jenë konform normave dhe rregullave teknike.

Neni 19

Shitorja me sipërfaqe shitëse me mbi 1.200 m² duhet të posedojë një gjenerator për prodhimin e energjisë elektrike, për nevojat e pajisjeve për ftohje, regjistër të kasafortës dhe për ndriçim të domosdoshëm

Neni 20

Shitorja duhet të ketë ajrosje të mirë natyrore apo artificiale. Në rast se ajrosja natyrore nuk është e mjaftueshme, shitorja duhet të posedoi stabiliment për ajrosje artificiale.

Neni 21

Shitorja duhet të posedoi stabilimente të përshtatshme për ngrohje nëse kushtet klimatike e kërkojnë një gjë të tillë, po që se të punësuarit qëndrojnë gjatë tërë orarit ose më shumë se dy orë pa ndërpre në atë vend pune ,po qese mallrat të cilat gjenden në atë hapësirë e përballojnë nxjerrjen e hapësirës.

Pajisjet e shitores

Neni 22

22.1. Shitorja duhet të jetë e pajisur me rafte, stenda, tavolinat për shitje, gondolat, vitrinat ftohëse dhe pajisjet tjera të ngjashëm, varësisht nga organizimi i punës së shitores dhe lloji i mallit që shitet.

22.2. Pajisjet e shitores nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jenë të vendosura, respektivisht të ndërtuara në atë mënyrë që të mirëmbahen lehtë, ndërsa përbërja materialit për pajisjet duhet të jenë në pajtim me dispozitat e rregulloreve të veçanta që rregullojnë mbrojtjen dhe ruajtjen e jetës së njerëzve.

22.3. Shitoret në të cilat shitet buka, kiflet, mishi, peshqit, si dhe prodhimet e mishit dhe qumështit të cilat nuk janë në paketimin e tyre origjinal, shitorja duhet pajisur me lavaman për duar me ujë të nxehtë dhe të ftohtë.

Neni 23

Raftet, tavolinat shitëse, gondolat dhe pajisjet e ngjashme duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që hapësira në mes tyre të mundëson lëvizje të lirë të blerësve dhe të punësuarve.

Neni 24

Malli ekspozohet në shitore dhe vitrinat e shitores, por mundet të ekspozohet dhe në vitrinat lëvizëse ose në vitrinat e përhershme ekspozuese brenda shitores.

Neni 25

25.1. Malli në shitore duhet të ekspozohet sipas llojit dhe të jetë i renditur në mënyrë të rregullt.

25.2. Artikujt ushqimor nuk guxojnë të vendosen drejtpërdrejtë në dysheme të shitores ose afër mallit, vetit e të cilit mundet të ndikojë dëmshëm në artikujt e tjerë ushqimor.

25.3 Shitorja duhet të pajiset me instrumente matëse(peshore)të cilat duhet të janë të sakta dhe të vendosura në atë mënyrë që blerësve t'iu mundëson shikim në matjen e mallit

Hapësirat ndihmëse

Neni 26

26.1. Me hapësirat ndihmëse kuptojmë: lokalet dhe hapësirat për depo doracake hapësirat për vendosjen e mbeturinave të prishura, hapësirat ndihmëse për nevojat higjiene - sanitare të punësuarve, gjegjësisht për nevojat higjiene-sanitare të blerësve.

26.2. Në rast se shitorja ka depo përcjellëse, malli në depo duhet të vendoset në atë mënyrë që të sigurohet nga prishja, papastërtia dhe përzierja me mallra me veti të ndryshme.

Neni 27

27.1. Ambalazhi nuk guxon të vendoset dhe të ruhet në objektet shitëse dhe as para shitores, por vetëm në depo apo në vende tjera të përshtatshme.

27.2. Artikujt e prishur dhe mbeturinat tjera duhet të vendosen në kontejner ose enët tjera të caktuara, me mbrojtje të përshtatshme higjienike.

Neni 28

28.1. Shitorja duhet të ketë hapësirat ndihmëse për nevojat shëndetësore-sanitare të punësuarve. Madhësia e atyre hapësirave dhe pajisja e tyre duhet t'i përgjigjet numrit të punësuarve në shitore, në pajtim me rregullat e mbrojtjes në punë.

28.2. Përdorimi i hapësirave,nyejve sanitare për nevojat e të punësuarve duhet të sigurohet jo më larg se 100 m nga shitorja.

Neni 29

Dyshemetë dhe muret e hapësirave përcjellëse nga neni 28 paragrafi 1 të këtij Udhëzimi duhet mveshur me pllaka qeramike ose material të përshtatshëm, në lartësi jo më pakë se 1,50 m nga dyshemeja.

2. Dispozitat e Veçanta për Shitoret me Mënyra të Caktuara të Shitjes

a) Vetëshërbimi

Neni 30

30.1. Shitorja në të cilën shitja e mallit me pakicë organizohet në mënyrë të vetëshërbimit të blerësve (vetëshërbyerje), duhet pajisur me shportat për bartjen e mallit, e nëse hapësira e shitores është më e madhe se 400 m² duhet pasur edhe karrocat për bartjen e mallrave.

30.2. Në shitoren nga paragrafi 1 i këtij neni, gjerësia ndërmjet rafteve me mallra të ekspozuara duhet të jetë të paktën 1 m, e nëse blerësit për bartjen e mallit përdorin karrocat gjerësia duhet të jetë së paku 1.20 m.

b) Shtëpia e mallrave

Neni 31

Shitorja në të cilën bëhet shitja e mallit me pakicë me përzgjedhje më të madhe për konsum të gjerë dhe e organizuar sipas rregullave që për lloje të caktuara të mallit ekzistojnë sipërfaqe të veçanta shitëse, dhe shitja bëhet në formë të vetëshërbimit, shërbimit, në mënyrë klasike, apo përmes automatit, pa tjetër shitorja duhet të ketë sipërfaqe shitës jo më pak se 600 m².

Neni 32

Shitorja në të cilën ushtrohet shitja sipas nenit 31 e që ka të bëjë me shitje të mallit në sasisë më të madhe, shitoren duhet pajisur me karrocat për bartjen e mallit deri te automjetet transportuese të blerësve.

3. Depot në të cilat ushtrohet tregtia me pakicë

Neni 33

Depot në të cilat ushtrohet tregtia me pakicë duhet ti përmbushin kushtet e parapara me këtë udhëzim për depot në të cilat ushtrohet tregtia me shumicë

III HAPSIRAT E PUNËS NË TË CILAT USHTROHET TREGTIA ME SHUMICË

1 Depot

Neni 34

34.1. Depoja në të cilën ushtrohet shitja e mallrave me shumicë duhet të jetë e mbyllur, bëhen përjashtime dhe depoja mund të jetë zbuluar apo e hapur, nëse lloji i mallit ose kushtet klimatike një gjë të tillë e lejojnë.

34.2. Brenda depos duhet siguar rrugica përkatëse për qarkullimin e papenguar të mjeteve dhe personave.

34.3. Trualli në të cilën është ndërtuar depoja duhet të jetë i mbrojtur me rrethojë mbrojtëse në lartësi të paktën 2 m, rrethoja nuk guxon të jetë me tel gjemborë, përveç në rast se depoja ndodhet jashtë vendit të banuar.

34.4. Depoja e mbuluar ose e hapur mund të ndërtohet vetëm në tokën (truallin) e atë në të cilën është zgjedhur rrjedha e ujit apo është vendosur drenazhi.

Neni 35

35.1. Në përbërjen e depos duhet të sigurohet:

- hapësira e caktuar për vendosjen e ambalazhës kthyese dhe mbeturinave,
- hapësira ndihmëse për nevojat shëndetësore-sanitare të punëtorëve në pajtueshmëri me nenin 28 të këtij udhëzimi.

Neni 36

36.1. Depoja gjatë orarit të punës, duhet të jetë e ndriçuar me dritë natyrore ose artificiale dhe duhet të ketë ajrosje natyrore apo ventilim artificial, e nëse lloji dhe përbërja e mallit e kërkon duhet të pajiset me pajisje përkatëse klimatike.

36.2. Ndërtimi i dyshemesë duhet të jetë i ndërtuar nga materiali i cili pastrohet lehtë (nga teraco, qeramika, gurë, gomë).

36.3. Muret dhe shtyllat e depos duhet të ngjyrosen dhe nuk duhet dëmtuar.

36.4. Sipërfaqet e depove të cilat i ekspozohen më shumë ndotjes, duhet të mveshen me qeramikë apo materiale tjera të përshtatshme në lartësi jo më pak se 1.80 m.

36.5. Dyshemetë e depove të mbyllura por edhe të hapura duhet të ndërtohen prej materialeve të cilët mundësojnë kushte të mira të qëndrimit dhe të kanë pjerrtësi që mundëson kulluarën(largimin) e ujit të mbledhur në dysheme.

Neni 37

37.1. Depoja duhet t'i ketë të instaluar stabilimentet e përshtatshme për vendosjen dhe ruajtjen e mallit me të cilën sigurohet ruajtja kualitative e mallit.

37.2. Depoja duhet të ketë pajisje për transportin e brendshme, vegla dhe mjete me të cilat mundësohet manipulimi më i lehtë i mallit, e nëse depoja është e ndërtuar në dy ose më shumë kate, atëherë duhet pasur pajisje për ngritjen e ngarkesës dhe shkallët e gjerësisë së duhur për dërgesën e mallit.

37.3. Malli në depo vendoset në mënyrë që të siguron hapësirë të mjaftueshme të lirë për kalimin e të punësuarve dhe blerësve, si dhe për qarkullimin e mjeteve për manipulim me mallin.

37.4. Depoja duhet të sigurojë hapësirë për qasje të automjeteve transportuese mjeteve tjera të përshtatshme të destinuara për ngarkim dhe shkarkim si dhe telefon.

2. Hapësirat në të cilat ushtrohet tregtia me shumicë e bazuar në ekzemplar dhe transit

Neni 38

Hapësirat në të cilat ushtrohet tregtia me shumicë sipas ekzemplarëve apo në mënyrë të ngjashme në përbërjen duhet të kenë;

- Hapësira për kryerjen e punëve administrative për pranimin e palëve afariste,
- Hapësira për ekspozimin e ekzemplareve
- Hapësirë ndihmëse për nevoja higjienike-sanitare për personelin dhe për të cilat kushte vlejné dispozitat e nenit 29 të këtij Udhëzimi
- Hapësirat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të janë të pajisura me telefon.

Neni 39

Për ushtrimin e tregtisë me shumicë në transit është e domosdoshme me se paku një hapësirë për kryerjen e punëve administrative dhe telefon përkatësisht telefaks si dhe hapësira ndihmëse për nevojat higjienike-sanitare të punësuarve.

3. HAPSIRAT NË TË CILAT BËHET GRUMBULLIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE DHE PRODHIMEVE TJERA(STACIONET GRUMBULLUSE)

Neni 40

40.1 Stacioni grumbullues nënkupton objektin në të cilin bëhet grumbullimi i prodhimeve bujqësore, kafshëve, lëkurave, prodhimeve pyjore dhe prodhimeve tjera.

40.2 Dyshemeja e stacioneve grumbulluese duhet të rregullohet sipas kushteve dhe rregullave teknike për atë lloji të ndërtimit, në mënyrë që të sigurohet larja e dyshemesë.

40.3 Pjesa e hapur e stacionit grumbullues duhet rregulluar në atë mënyrë që të mundësoi pastrimin dhe mirëmbajtjen e lehtë

Neni 41

Stacioni Grumbullues varësisht nga lloji i mallit që grumbullohet në të, se paku duhet të ketë një hapësirë afaristë të mbyllur në lartësi prej më së paku 2.80 m kurse hapësira e tërësishme nuk guxon të jetë më e vogël se 10m²

Neni 42

42.1 Objekti (lokali) i stacionit grumbullues duhet të jetë i ndërtuar, rregulluar ,pajisur dhe kyçur ne objektet dhe stabilimentet e infrastrukturës komunale: furnizimi me ujë-lidhja në kanalizimin e ujërave të zeza si dhe furnizimi me energji elektrike ne pajtueshmëri më normat dhe rregullat teknike.

42.2 Përfshirë nga paragrafi 1 i këtij neni bëjnë objektet që gjenden në vendet ku nuk janë të ndërtuara objektet dhe infrastruktura komunale, ndërsa të njëjtat duhet ndërtuar, rregulluar dhe përgatitur në pajtueshmëri me normat dhe rregullat teknike.

42.3 Mbeturinat e ngurta duhet mbledhur në vendin e caktuar dhe të paraparë më herët duke siguruar kushtet e nevojshme shëndetësore-teknike dhe largimin e tyre në mënyrën si e ka përcaktuar organi kompetent komunal.

Neni 43

43.1 Vendi Grumbullues duke pas parasysh llojin e mallit i cili grumbullohet duhet pajisur edhe me mjete të përshtatshme për manipulim me mallin dhe ruajtjen e gjendjes së rregullt shëndetësorë të prodhimeve.

43.2 Stacioni grumbullues duhet të posedoi mjete për matjen (peshore etj)

Neni 44

44.1 Vendi Grumbullues duhet të ketë njëje sanitare, me para hapësirë e të cilën duhet pajisur me lavaman furnizim me ujë si dhe mjete higjienike(sapun Letër) shportë për mbeturina etj.

44.2 Shitësve të mallrave në stacionet grumbulluese duhet t’iu sigurohet përdorimi i njëjve sanitare.

Neni 45

Stacionin Grumbullues në të cilin behët grumbullimi i kafshëve duhet rrethuar , ndërtuar nga materiali i përshtatshëm me numër të mjaftueshme të hyrjeve dhe daljeve të cilat mund të mbyllen, vende për lidhjen e kafshëve, vendin për ngarkimin-shkarkimin si dhe pajisje për furnizimin me ujë të pijshëm për kafshë.

4. Tregjet me Shumicë

Neni 46

Tregjet me shumicë janë vende të organizuara dhe të rregulluara në mënyrë të veçantë në të cilat kryhet shitja dhe blerja me shumicë e prodhimeve bujqësore si dhe magazinimi i mallit.

Neni 47

47.1 Tregjet me shumicë në përbërjen e tyre duhet pasur:

- Hapësira për ekspozimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore
- Një ose me shumë hapësira të veçanta për magazinimin e prodhimeve bujqësore e të pajisura me mjete të përshtatshme për transport dhe manipulim me mallin,
- Vend për parkim për mjetet transportuese
- Hapësira ndihmëse për nevojat higjienë-sanitare të nevojshme për personelin dhe palët, hapësirat duhet ndërtuar dhe pajisur konform neneve 28 dhe 29 të këtij udhëzimi
- Hapësirë të veçantë të destinuar për vendosjen e mbeturinave po qese nuk është siguruar largimi ditor i mbeturinave
- Gjeneratorë për prodhimin e energjisë elektrike nëse në magazina janë të vendosura mallra për cilat shfrytëzohen stabilimentet për ftohje.

47.2. Tregjet me shumicë në përbërjen e tyre duhet pasur hapësira të caktuara për pune administrative profesionale lidhur me ofrimin shërbimeve klientëve.

Neni 48

Objektet e veçanta për magazinimin e prodhimeve bujqësore duhet të pajisen me stabilimente ftohëse dhe ngrohëse përkatësisht për kondicionimin e ajrit me të cilat pajisje sigurohet ruajtja e prodhimeve për periudha më të gjata kohore të destinuara për tregjet me shumicë dhe që mundësojnë kryerjen e procesit të mpjekjes së atyre prodhimeve që janë të varura nga ky proces

IV .OBJEKTET NË TË CILAT USHTROHET NDERMJETËSIMI NË TREGTI

Neni 49

49.1 Për objektet në të cilat ushtrohet ndërmjetësimi në tregti vlejné dispozitat e këtij udhëzimi varësisht nga lloji dhe mënyra e ushtrimit të ndërmjetësimi.

49.2 Një pjesë e hapësirës në të cilin ushtrohet ndërmjetësimi në tregti me mallra duhet të parashihet për pranimin e palëve nëse për atë qëllim nuk është siguruar hapësira e veçantë.

Neni 50

Hapësirat në të cilat ofrohet shërbimi i magazinimit, (deponimit) të mallit duhet plotësuar kushtet e përcaktuara më këtë Udhëzim të parapara për depot në të cilat kryhet shitja e mallit me shumicë.

V SHITJA JASHTË SHITORËS

1.Dispozitat e Përgjithshme

Neni 51

Shitja jashtë shitores mund të bëhet në tregjet me pakicë, kioske, në stendat, përmes shitësve ambulant, automatëve dhe panairove, po qese për këto lloje të shitjes janë të parapara vendet e caktuara me akte ligjore të Kuvendeve Komunale

Neni 52

52.1. Personat juridik dhe fizik të cilët shesin jashtë shitoreve, janë të obliguar të mbajnë evidencë për regjistrimin e mallit në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores për mënyrën e udhëheqjes së librave dhe evidencave të mallit me pakicë dhe për çdo shitje blerësit t'i lëshohet fatura.

52.2 Bëjnë përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni personat fizik të cilët mirën me prodhimin e produkteve bujqësore si dhe nuk lëshohet faturë për shitjen e shtypit ditor, prodhimeve të duhanit ,lotarinë, prognozot sportive,markat dhe letrat postare

2.Tregjet me Pakicë

Neni 53

53.1. Tregu me pakicë (në tekstin vijues tregu) është hapësirë e ndërtuar dhe e rregulluar, në të cilin bëhet shitja e artikujve ushqimor dhe mallrave tjerë në pajtim me rregullin e tregut dhe në pajtim me këtë Udhëzim.

53.2. Në treg nuk mund të shiten mallrat të cilat me ligje të veçanta janë të ndaluara për shitjen në treg me pakicë.

Neni 54

54.1. Në treg bëhet shitja e prodhimeve bujqësore :

- pemë dhe perime
- vezët
- lulet

54.2. Bëjnë përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, dhe mund të shiten në treg edhe mallrat tjera, nëse janë të përmbushura kushtet për shitjen e mallrave të caktuara me pakicë e të definuar me këtë Udhëzim dhe akte tjera ligjore.

Neni 55

55.1. Hapësira shitëse e tregut mund të jetë e mbyllur dhe e hapur.

55.2. Lartësia e hapësirës së mbyllur shitëse duhet të jetë së paku 6 m, e në rast të veçanta mund të jetë edhe më e ulët se 6 m, mirëpo jo më e ulët se 4 m, po qese janë siguruar kushtet për ajrosje.

55.3. Stendat e shitjes në treg duhet ta kenë sipërfaqen shfrytëzuese më se paku 6 m².

Neni 56

56.1 Lokalet e vendosura në treg e të cilat sipas dispozitave të këtij udhëzimi paraqesin shitore përkatësisht kioske, duhet marr parasysh se çka tregtohet në to dhe duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara më këtë udhëzim.

Neni 57

57.2. Tregu duhet pasur :

- hapësirën e destinuar për depo me pajisjet për ftohje me madhësi adekuate për ruajtjen e mallit;
- hapësirën e përshtatshme për përgatitjen dhe ruajtjen e peshoreve, ombrellave kundër diellit si dhe mjeteve tjera që shfrytëzohen nga shitësit;
- sipërfaqe të veçantë për vendosjen e mbeturinave;
- numër të mjaftueshëm të sipërfaqeve ndihmëse për nevojat shëndetësore-sanitare të shitësve dhe blerësve.

57.3. Në sipërfaqet ndihmëse për nevojat higjienë-sanitare nga paragrafi 1, pikave 3 dhe 4 i këtij neni, vlejnë dispozitat e nenit 29 të këtij Udhëzimi.

Neni 58

58.1. Objektet e tregut duhet të jenë të kyçura në ujësjellësin, kanalizimin dhe rrjetin elektrik publik.

58.2. Sipërfaqet e hapura të shitjes duhet të kenë ndriçim publik.

58.3. Për hapësirat e mbuluara të tregut sa i përket ndriçimit aplikohen dispozitat e nenit 15 të këtij Udhëzimi.

58.4. Sipërfaqet e mbyllura të shitjes duhet të jenë të rregulluara dhe të pajisura me stabilimente që gjatë stinës së verës temperatura mos të jetë më e lartë se + 20 C.

Neni 59

59.1 Për ndërtimin dhe pamjen e dyshemeve, mureve dhe shtyllave të pjesës së mbyllur të tregut, aplikohen dispozitat e nenit 17 të këtij Udhëzimi.

59.2 Për dyshemetë e pjesës së hapur të tregut, në mënyrë të njëjtë aplikohen dispozitat e nenit 36. pika 2 e këtij udhëzimi.

Neni 60

60.1. Tregu duhet të jetë i pajisur me numër të mjaftueshëm të stendave shitëse dhe peshoreve, në mënyrë që për çdo stendë të sigurohet të paktën një peshore.

60.2. Sipërfaqja e epërme e stendave shitëse nga paragrafi 1 i këtij neni, duhet të rregullohet nga materiali i lërueshëm, pa qarje e cila pastrohet lehtë.

60.3. Stendat shitëse duhet të jenë të vendosura në atë mënyrë që në mes tyre të mbetet gjerësi e mjaftueshme për qarkullim të pa penguar të shitësve dhe blerësve.

60.4. Hapësira ndërmjet stendave duhet të jetë e gjerë së paku 2 m.

Neni 61

61.1 Në treg duhet të ndahen dhe shënjohen hapësirat për shitjen e llojeve të caktuara të mallrave sipas grupeve.

61.2 Në stendat e shitjes në të cilat shiten pemët dhe perimet, prodhimet e qumështit dhe vezët nuk mund të shiten edhe prodhime tjera.

Neni 62

62.1 Artikujt në paketim origjinal mund të shiten vetëm në hapësirat e mbyllura të tregut, në pajtim me rregullat për mënyrën e ruajtjes, vendosjes dhe shitjes së artikujve, si dhe rregullave për sigurim shëndetësor të artikujve ushqimor.

62.2 Për shitjen e llojeve të veçanta të artikujve (artikujt që lehtë prishen) duhet të sigurohen pajisjet e temperaturave të ulëta për ruajtjen e tyre

Neni 63

63.1 Mjetet e përdorimit të përgjithshëm (mjete për higjienë personale, për zbukurimin e fytyrës, për mirëmbajtjen e pastërtisë) mundën të shiten në treg vetëm nëse një pjesë e tregut është i rregulluar për shitjen e atyre artikujve, në mënyrë që ato mjete të sigurohen nga ndikimet e dëmshme atmosferike dhe ndikimeve të tjera.

63.2 Veglat e ndryshme për amvisëri: enët për ushqim, prodhimet nga thuprat dhe kashtës, prodhimet e drurit, qeramikës, tekstilit, xhamit dhe plastikës e të ngjashme për

amvisëri mund të shiten në treg vetëm në vendet të ndara dhe të rregulluara për shitjen e prodhimeve të tilla.

63.3 Artikujt e veshmbathjes, mund të shiten në treg në vendet e ndara dhe të rregulluara për shitjen e atyre prodhimeve me kusht që ato prodhime të jenë prodhime vetanake.

Neni 64

Në treg nuk mund të shiten aparatet elektroteknike dhe elektronike, aparatet e radios dhe TV-së, makinat dhe pjesët e tyre.

3. Kioskat

Neni 65

65.1. Kioska, sipas dispozitave të këtij Udhëzimi, është hapësira në të cilën shiten mallrat me pakicë përmes sportelit, pa mundësi hyrje të blerësit në brendësi të kioskat.

65.2 Lartësia e kioskat nuk duhet të jetë më e vogël se 2.20 m, kurse hapësira e lirë e dyshemesë nuk mund të jetë më e vogël se 2 m², me kusht që në hapësirën e kioskut të sigurohen kushtet mikroklimatike.

65.3 Konstruksioni i kioskut duhet të jetë i atillë që shitësit t'i siguron mbrojtje nga ndikimet atmosferike. Dyshemenë e kioskut duhet rregulluar prej materialit i cili siguron nxehtësi.

65.4 Nëse shitësi qëndron gjatë tërë orarit të punës në kioskë, ose më gjatë se dy orë, në kohë me mot të ftohtë, duhet të sigurohet nxehje në kioskë.

Neni 66

66.1 Kioska në të cilën shiten buka, kiflet, mishi, peshku dhe prodhimet e mishit dhe të qumështit, e të cilët nuk janë në paketimin e tyre origjinal, kioska duhet të jetë i pajisur me lavaman, ujë të nxehtë dhe të ftohtë.

66.2 Kioska duhet të ketë hapësirat ndihmëse për nevojat sanitare dhe shëndetësore të punësuarve në largësi jo më të madhe se 100 m.

4. SHITJET E TJERA JASHTË SHITORES

a)Shitja në tavolina

Neni 67

67.1. Në tavolina (jashtë tregut) mund të shitet vetëm ai mall i cili sipas cilësive të tij mund të shitet jashtë shitores.

67.2. Shitja e mallrave në tavolinë mund të bëhet vetëm në vendet për të cilat organet e qeverisjes lokale kanë dhënë lejen paraprake.

67.3. Për shitjen e artikujve, përveç lejes nga pika 2 i këtij neni, është e domosdoshme edhe pëlqimi i inspeksionit sanitar, në pajtim me dispozita e Udhëzimit Administrativ për inspeksionin sanitar të Kosovës.

67.4. Në tavolinën shitëse duhet vendosur firma e personit juridik apo fizik i cili ushtron aktivitet tregtar.

Neni 68

68.1 Shitja e artikujve në tavolinë mund të bëhet vetëm nëse janë siguruar kushtet në vijim:

- mbrojtja e tavolinës nga veprimi i dëmshëm i rrethit (pluhuri, gaz i automjeteve, dielli, era etj.),
- pastrimi dhe larja e vendeve të shitjes,
- mënjanimi ditor i mbeturinave.

68.2 Për shitjen e llojeve të caktuara të artikujve (artikujve që lehtë prishen) duhet të sigurohen pajisje për temperaturë të ultë për ruajtjen e tyre.

68.3 Për shitjen e shalqinjve, pjepreve, specave, lakrave, patateve dhe llojet tjera të pemëve dhe perimeve duhet të sigurohet një shtresë për vendosjen e mallit e cila duhet të jetë e ngritur nga sipërfaqja e tokës.

Neni 69

Shitja e artikujve për përdorimi të përgjithshëm, veçanërisht ato të higjienës personale, për zbukurim (të fytyrës dhe trupit) të cilat i ekspozohen prishjes munden të shiten në tavolina vetëm nëse është siguruar mbrojtja nga ndikimi i rrethit dhe nëse për ekspozimin e tyre janë siguruar pajisjet për rregullim të temperaturave të përshtatshme për ato artikuj

.

Neni 70

70.1 Në tavolina nuk mund të shiten aparatet elektroteknike dhe elektronike, aparatet e radios dhe TV-së, makinat dhe pjesët e tyre.

70.2 Përveç prodhimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, në tavolina nuk mundë të shiten mallrat të cilat sipas dispozitave të caktuara ligjore ndalohen të shiten jashtë shitoreve.

b)Shitësit Lëvizës/Ambulantor

Neni 71

71.1 Sipas këtij Udhëzimi, shitësi ambulant nënkupton shitjen pa vend të përhershëm të shitjes, shitja bëhet përmes automjeteve të rregulluara dhe pajisura enkas për shitjen e mallit, gjegjësisht përmes karrocave të cilat lëvizin nga vendi në vend ose përmes objektit lundrues i cili është i përgatitur për shitjen me pakicë të grupeve të caktuar të prodhimeve.

71.2 Shitësi ambulant mund të bëjë shitjen vetëm në vendet për të cilat organet e qeverisjes lokale kanë dhënë lejen paraprake.

71.3 Për shitësit ambulant, aplikohen dispozitat e nenit 53 të këtij Udhëzimi.

Neni 72

Shitja lëvizëse e prodhimeve industriale të ngrira dhe të paketuara si dhe shitja e akulloreve të pa paketuara mund të bëhet vetëm në mënyrë të përcaktuar me rregullore për mbrojtjen shëndetësore të prodhimeve, sipas Udhëzimit Administrativ për mbikëqyrjen Sanitar

c)Automatët

Neni 73

73.1 Shitja përmes automatëve jashtë shitores mundet të bëhet vetëm në vendet për të cilat lejen e kanë dhënë organet kompetente të qeverisjes lokale, përkatësisht pronari ose shfrytëzuesi i hapësirës në të cilin është vendosur automati.

73.2 Në automat duhet të vendoset firma e pronarit të automatit.

Neni 74

74.1 Shitja me ndihmën e automatëve kryhet në pajtim me kushtet teknike dhe përgatitjen e automatit varësisht nga lloji i prodhimit që shitet.

74.2 Tregtari i cili bënë shitjen e mallrave përmes automatit është i obliguar të përcjellë dhe të siguroj funksionimin e rregullt të automatit.

Neni 75

Shitja e akulloreve dhe pijeve joalkoolike përmes automatit mundet të bëhet vetëm në rast se është e rregulluar me normat e rregullta shëndetësore dhe kontrollit të artikujve.

Neni 76

76.1. Për shitjen e mallrave në tregjet, kioskat, stendat, përmes shitësve ambulant, automatëve, si dhe shitjen e mallrave përmes postës dhe në hapësirat e blerësve, tregtari duhet të sigurojë kushte për vendosje të përshtatshme të mallit të cilin e shet jashtë shitores, dhe me mallin të manipulon në mënyrë që të siguron ruajtjen e kualitetit dhe cilësisë së prodhimeve.

76.2. Për shitjen e mallit në mënyrën e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni, tregtari është i obliguar të veproj konform dispozitave për mbrojtjen e konsumatorëve.

5.PANAIRËT

Neni 77

77.1 Organizatoret e panairove të lajmërohen sipas ekzemplarëve përkatësisht organizatoret e panairove për prodhuesit afariste duhet të kanë objektet e mbyllura dhe të hapura të përshtatshme për organizimin e tyre si dhe të pajisen me mirë pëlqim nga Kuvendi Komunal

77.2. Panairot e hapur duhet të jenë të rrethuar me rrethojë të fortë.

77.3. Ekspozuesve të mallit duhet t'iu sigurohet përdorimi i telefonit dhe faxit, e nëse kushtet e lejojnë edhe qasje në internet, kurse për qëndrimin e tyre duhet që në kuadër të hapësirës së panairit të sigurohet pjesë e caktuar e destinuar për punë afariste si dhe hapësirat ndihmëse për nevojat higjienë-sanitare.

77.4 Hapësirat ndihmëse nga pika 3 dhe 54 të këtij neni duhet të jenë të rregulluara dhe të pajisura konform me nenet 29 dhe 30 të këtij Udhëzimi.

PANAIRET E KAFSHEVE

Neni 78

78.1 Për panairot e Kafshëve vlejné kushtet minimale teknike të përcaktuara më këtë Udhëzim për stacionet grumbulluese nëse nuk është caktuar ndryshe me rregulla të veçanta.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 79

79.1. Tregtarët të cilët në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi i përmbushin kushtet e përcaktuara me këtë Udhëzim në lidhje me kushtet minimale teknike për lokalet e punës në të cilat zhvillohet tregtia e mallrave dhe shërbimeve, vazhdojnë me punën sipas kushteve nga ky udhëzim.

79.2. Tregtarët nga paragrafi 1 i këtij neni, janë të obliguar që për ushtrimin e aktiviteteve tregtare t'i përshtaten kushteve të përcaktuara nga ky Udhëzim me së largu 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 80

80.1 Tregtarët me pakicë do t'i rregullojnë objektet e veta të punës dhe tregjet dhe marrëdhëniet me blerësit e hapësirave të tregut me dispozitat e këtij Udhëzimi në afat prej 3 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, kurse tregtarët të cilët shesin mallra në treg në të njëjtën kohë t'i harmonizojnë aktivitetet e veta afariste sipas këtij Udhëzimi.

80.2. Nëse tregtarët nga pika 1 i këtij neni nuk i rregullojnë aktivitetin e vet afarist, tregjet janë të obliguar t'i shkëpusin kontratat e tyre të blerjes me blerësit

80.3 Në afatin nga pika 1 i këtij neni edhe tregtarët që shesin mallra jashtë tregut duhet t'i rregullojnë aktivitetet e veta afariste.

Neni 81

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi, do të pushojnë të vlejnë të gjitha rregulloret relevante për përcaktimin e kushteve minimale për hapësirat afariste në të cilat zhvillohet tregtimi i mallrave me pakicë, shumicë dhe shërbimeve, përveç për tregtarët të cilët kanë filluar të merren me aktivitet tregtare para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi, e më së voni deri në afatin e përcaktuar nga neni 82 pika 2 i këtij Udhëzimi. .

Neni 82

Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë.

Më datën 29.3.2005
Prishtinë

Ministri i MTI-së,

Mr. Bujar Dugolli